



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.2/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi, anëtarë, me zyrtarin e lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Prizren, kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunën e Prizrenit, në seancën e panelit të mbajtur me 19.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Prizren i parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunën e Prizrenit.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit nga subjekti politik PDAK me seli në Prizren me datën 18.05.2017 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së me të cilin pretendon se KQZ nuk e ka pranuar dhe nuk e ka nominuar për anëtar të Komisionit Komunal Zgjedhor në Prizren personin Gëzim Morina i lindur me datën 25.12.1967.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar që të anulohet vendimi i KQZ-së dhe të emërohet si anëtar i KKZ-së përfaqësuesi nga radhët e subjektit politik PDAK, pasi që ky subjekt prin dhe ka pasur më shumë vota se partitë tjera të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datën 18.05.2017 e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar nga ky komision që deri më datë 19.05.2017 në orën 12:00 të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ theksohet se subjekti politik PDAK nuk e ka fituar numrin e votave në nivel komunal për zgjedhjet nacionale ashtu siç pretendohet nga parashtruesi i apelit me propozim për PZAP-in që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli i ka vlerësuar apelin e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, se pala parashtruese e apelit ka të drejtën e parashtrimit të apelit dhe se PZAP-i ka kompetencën e shqyrtimit të apeleve dhe të nxjerrë vendime për apelimet e tilla. Paneli ka gjetur se përveç pretendimeve të thëna si më lartë, pala parashtruese nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e parashtruara në apel.

Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja për nominimin e kandidatit për KKZ në komunën e Prizrenit i është bërë e padrejte dhe se subjekti politik PDAK ka pasur me shume vota se partitë tjera minoritare të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë të paqëndrueshme ngase subjekti politik PDAK që është parashtruesi i apelit në këtë rast, nuk ka fituar vota në nivel komunal për zgjedhjet nacionale.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se vendimi i apeluar i KQZ-së, për nominimin e kandidatit të KKZ-së në Komunën e Prizrenit, është i bazuar në ligj dhe është në harmoni të plotë me nenin 67 par. 1 dhe 3 të LZP-se në të cilin KQZ-ja është përpjekur dhe ka garantuar përfaqësimin e drejtë të KKZ-së, në komunën e theksuar më lart, për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 2/2017 më datën 19.05.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.